

“SHQIPTARËT NA E SHPËTUAN JETËN”

Felicita Jakoel



Intervistë e zonjës Felicita Jakoel, Kryetare e Shoqatës Shqipëri-Izrael, dhënë ish-ambasadorit shqiptar z. Mal Berisha




“Intervista e plotë, me zë dhe figurë, gjendet në platformën YouTube.

https://youtu.be/_ErnH84dmrl

Pyetje: Mal Berisha:

Jemi me zonjën Felicita Jakoel, mbesa e njërit prej hebrenjve më të shquar të Shqipërisë, të cilët kanë jetuar në vendin tonë. E bija, po ashtu, e një hebriu tjetër, i cili ka marrë në shënim të gjitha rekordet e pranisë hebraike në Shqipëri. Dhe, për fatin tonë, është një vajzë e lindur në Shqipëri, në regjimin komunist, shtetase izraelite tashmë dhe shqiptare, e cila është dëshmitare e njërit prej virtyteve më të mira kombëtare shqiptare, që është mungesa e plotë e antisemitizmit. Çfarë mund të thonim lidhur me këto gjëra?



Përgjigje: Felicita Jakoel:

Familja ime nga ana e babait, gjyshërit e mi, janë vendosur në Shqipëri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Babai im këtë komunitet hebre e quan vala e tretë e pranisë së hebrenjve në Shqipëri. Kemi një valë të parë që është para dy mijë vjetësh dhe një nga zbulimet më të rëndësishme është zbulimi i sinagogës në Sarandë, që dëshmon për një komunitet të madh dhe të mirëvendosur, pasi ata kishin një sinagogë kaq të madhe dhe kaq të rëndësishme. Vala e dytë është në kohën e Mesjetës, kur erdhën në Shqipëri hebrenjtë e përndjekur nga

Inkuizicioni spanjoll. Edhe ata u vendosën në Vlorë dhe, sipas arkivave, në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, në Vlorë gjysma e popullsisë ishte popullsi hebraike. Pas njëqind vjetësh, pak a shumë, edhe ky komunitet u zhduk ose u kthye në Greqi.

Pjesa më e madhe u largua, ndërsa një pjesë tjetër kaloi të jetonte në Berat dhe në Elbasan. Më vonë, edhe këto dy komunitete u shpërngulën ose u konvertuan. Ata të Beratit u bënë myslimanë, ndërsa ata të Elbasanit u bënë të krishterë. Për rreth njëqind vjet, domethënë nga shekulli i shtatëmbëdhjetë deri në shekullin e tetëmbëdhjetë, nuk kemi të dhëna për një prani hebraike në Shqipëri.

Vala e tretë, siç e quan im atë në librin e tij ***Izraelitët në Shqipëri***, i përket fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur hebrenjtë vijnë nga Janina dhe nga veriu i Maqedonisë.

Pse vijnë në Vlorë? Mendoj për dy arsye.

Së pari, e gjithë ajo zonë ishte një sanxhak nën Perandorinë Osmane dhe ata kishin të drejtën e lëvizjes.



Së dyti, vinin në Vlorë sepse Vlora ishte port dhe u jepte mundësi të zhvillonin aktivitetet e tyre tregtare. Një arsye tjetër ishte fakti se dikur kishte pasur hebrenj në Vlorë. Dhe, vërtet, ata gjetën varrezat dhe sinagogën e vjetër të Vlorës.

Kështu që ky komunitet që u vendos në Vlorë ishte shumë i vogël. Bëhet fjalë për rreth dyqind persona, jo familje. Por ajo që kishte më shumë rëndësi ishte se këta hebrenj kishin marrëdhënie

të shkëlqyera me popullsinë vendase. Mendoj se këto marrëdhënie kaq të mira mund t'i ilustroj me një shembull.

Në periudhën e Mbretit Zog, hebrenjtë kishin dyqanet e tyre në sheshin e pazarit kryesor të Vlorës. Siç dihet, dita e pushimit është e diela, por për hebrenjtë dita e pushimit është e shtuna. Për këtë arsye, ata i mbyllnin dyqanet të shtunën dhe nisën ankesat. U tha se hebrenjtë po i mbyllnin dyqanet dhe se po shëmtohej pazari i Vlorës.

Çfarë bënë autoritetet e bashkisë së Vlorës? Filluan t'u vendosnin gjoba hebrenjve, duke u kërkuar që t'i hapnin dyqanet të shtunën dhe të pushonin të dielën. Po hebrenjtë çfarë bënë? I hodhën në gjyq dhe është e pabesueshme që, në kohën e Zogut, hebrenjtë e fituan gjyqin. Pse? Sepse, sipas Kushtetutës, çdo njeri kishte të drejtë të ushtronte urdhërimet e besimit të vet.

Dhe vërtet, babai im, në librin e tij, shkruan për periudhën e Zogut:

“Periudha e artë e komunitetit hebre në Shqipëri.”



Ata kishin të gjitha të drejtat: kishin të drejtën e lëvizjes, kishin të drejtën të ushtronin profesionin e tyre dhe, çka ishte shumë e rëndësishme për hebrenjtë, kishin të drejtën të ishin në kontakt me komunitetet mëmë, domethënë me komunitetin e Janinës, të Prevezës apo të Korfuzit.

Sepse, siç e dini, për hebrenjtë ishte dhe mbetet e rëndësishme ruajtja e identitetit. Atëherë, si duhet ruajtur identiteti?

Edhe nëpërmjet martesave. Kështu që kjo ishte një periudhë në të cilën hebrenjtë u ndjenë vërtet jashtëzakonisht mirë në Shqipëri. Këto marrëdhënie të mrekullueshme u vërtetuan më pas në mënyrë të jashtëzakonshme gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe, sidomos, gjatë pushtimit nazist.

Pyetje: Mal Berisha:

Duke qëndruar te pushtimi nazist: Familja juaj ka një histori shumë kuptimplote, sepse në kohën kur nazistët po i grumbullonin hebrenjtë në të gjithë Evropën, dihet fati tragjik që i priste në shumë vende. Dihet çfarë ka ndodhur me hebrenjtë e Selanikut, të cilët përbënin një shumicë të madhe të popullsisë dhe nga të cilët, në fund të luftës, u gjetën shumë pak të mbijetuar.

Shqipëria, si një vend i vogël, u pushtua nga gjermanët pas pushtimit italian. Natyrisht,

gjermanët, gjëja e parë që bënin, ishte përndjekja e hebrenjve. Ka një histori që lidhet me Xhafer Devën dhe gjyshin tuaj, i cili u thirr nga ministri i atëhershëm i Brendshëm i Shqipërisë, Xhafer Deva. A mund ta shpjegoni?

Përgjigje: Felicita Jakoel:

Po, shiko si është historia. Në qytetin e Vlorës, një ditë gjatë pushtimit gjerman, u varën nëpër muret e qytetit pamflete. Në këto pamflete ishte shkruar:

“Deri kur? Deri kur hebrenjtë do të vazhdojnë të jenë të lirë?”

“Kjo farë e keqe, që po çrrënjohet në gjithë botën, këtu deri kur do të ketë të drejta?”

Mateo Matathia dhe Pepe Levi, të cilët ishin pjesë e elitës së komunitetit, dolën nga dyqanet e tyre për t’u kthyer në shtëpi dhe, siç thuhet në shqip, ecnin me kokën ulur, të dërrmuar. Duke kaluar pranë bashkisë, panë se aty ishte mbledhur

këshilli i bashkisë, në prefekturë, më fal. Prefekti u tha: “Dërgojini këtu”, dhe ata u thirrën me zë të lartë.

Teksa po ngjiteshin lart dhe po hynin në zyrë, dëgjuan njërin nga anëtarët e këshillit, i cili i tha prefektit:

“Kjo që po ndodh është e padurueshme dhe e pafalshme. Ne nuk mund t’i trajtojmë në këtë mënyrë vëllezërit tanë hebrej. Për ne”, i thoshte ai – dhe ata e dëgjuan qartë – “do të ishte sikur të na kishin dhunuar motrat dhe gratë tona”.

Deri këtu. Ata hynë brenda dhe prefekti i qetësoi. U tha: “Ne do të jemi këtu për t’ju mbrojtur, por megjithatë gjermanit nuk i dihet. Prandaj ju këshilloj të shkoni në Tiranë dhe të takoni ndonjë eksponent të qeverisë”.

Kështu, gjyshi im Rafael Jakoel dhe Mateo Matathia, kunati i tij, shkuan në Tiranë. Atje kishin një mik të quajtur Bexhet Shpati, i cili ishte

kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Ia shpjeguan problemin dhe ai u tha:

“Së pari, ju nuk do të shkoni në hotel, sepse është shumë e rrezikshme. Ju do të rrini këtu, në shtëpinë time”.

Të nesërmen, ai shkoi dhe takoi Mehdi Frashërin dhe, nëpërmjet tij, u rregullua një takim me Xhafer Devën.

Sa herë që e mendoj këtë takim dhe, sipas përshkrimeve që më ka bërë im atë, më duket sikur shoh një film. Domethënë, dy hebrenj që shkojnë në Ministrinë e Brendshme, ndërsa gjermanët hyjnë dhe zbresin shkallëve. Është e ditur që Shqipëria kishte një qeveri kolaboracioniste.

Ata u ngjitën lart, hynë në zyrën e Xhafer Devës dhe ishin thellësisht të preokupuar. Pse? Sepse Xhafer Deva kishte studiuar në Gjermani dhe

njihej si një njeri me “Doiche kulturë”. Ata nuk ishin të sigurt se si do të sillej me ta.

Ai i uli, i qetësoi dhe pastaj hapi një sirtar, nxori një listë dhe u tha:

“Shikoni këto!

Kjo është lista e hebrenjve të Shqipërisë që na kanë kërkuar gjermanët. Sa të jemi ne këtu”, u tha ai, “nuk keni pse të preokupoheni, por në qoftë se do të na ndodhë neve diçka, ju duhet të kujdeseni për kokën tuaj”.

Dhe kështu ata u kthyen në Vlorë. Të rinjtë e kuptuan se nuk duhej të vareshin më vetëm nga fjalët e Xhafer Devës; duhej bërë diçka. Atëherë, babai im me motrën e vet, e cila ishte atëherë shtatëmbëdhjetë vjeç, ndërsa ai vetë ishte njëzet vjeç, shkuan në Tiranë.

Fëmijët e tjerë, që ishin tre, i mori në shtëpinë e tij Gjyheri, nga familja Gjyheri, dhe aty ndodheshin edhe pesë a gjashtë fëmijë hebrenj, të cilët

qëndruan në shtëpinë e tyre deri në fund të luftës. Babai im, bashkë me të motrën, erdhën në Tiranë. Ata ishin pesë kushërinj të parë, të cilët të gjithë morën me qira një apartament te Pazari i Ri. Shtëpia ekziston ende edhe sot.

Dhe, siç thotë babai im: “Një ditë kthehem”, thotë, “dhe kur shikoj poshtë ballkonit të shtëpisë, pashë një gjerman dhe një bashkëpunëtor, i cili i tregonte me dorë ballkonin”. Me një fjalë, po i thoshte: “Shiko, aty janë pesë hebrenj”.

Babai u ngjit me shpejtësi lart dhe u tha të gjithë kushërinjve: “Na kanë pikasur, duhet të shpërndahemi”. Ata tre të tjerët filluan ta qeshnin: “Ama ti”, i thanë, “ti gjithmonë ke frikë, ti gjithmonë e tepron”.

“Mirë”, u tha ai, “unë do ta marr motrën dhe do të iki. Ju bëni çfarë të doni”.

Dhe vërtet, Josefi, im atë, mori të motrën dhe shkoi në Kavajë, te familja Myrto.

Ishte Myrto, shoqëria Myrto. Kristini kishte qenë në të njëjtën klasë. Ajo e kishte takuar në rrugë dhe i kishte treguar babait se po na kërkonin. Ai i tha menjëherë, pa një pa dy: “Hajdeni në shtëpinë time”. Dhe ai qëndroi aty deri në fund të luftës.

Tani, çfarë ndodhi me ata të tre që kishin mbetur në apartament? Erdhen gjermanët dhe i arrestuan. Lajmi mbërriti në Vlorë: tre nga djemtë tanë janë arrestuar. Panik. Çfarë do të bënim? Ku të shkonim? Kujt t’i kërkonim ndihmë?

Vendosën përsëri gjyshi im dhe Mateo Matathia të shkonin te Ekrem bej Vlora. Ju e njihni figurën e Ekrem bej Vlorës. I shkuan në shtëpi.

Edhe kjo është, përsëri, një skenë filmi. Ata u ulën dhe ia shpjeguan problemin.

Ekrem bej Vlora u tha kështu:

“Aty ku jeni ulur ju”, u tha, “dje kisha Fitzcungun”, që ishte komandanti i trupave gjermane në Shqipëri. Dhe tha se ai kishte futur dorën në xhep

dhe po lëvizte diçka. Me sa duket, kishte disa monedha që bënë tring-tring. Dhe Ekrem bej Vlora i tha: “Çfarë ke aty?” Ai nxori dorën nga xhepi dhe i tregoi monedha floriri. Dhe i tha: “Po ta dish”, i tha, “edhe në luftë di të bësh para”. “Kaq?”, iu la të kuptohej. Që do të thoshte se duhej paguar. Dhe, nëse paguhej, mund të bëhej diçka.

Edhe këta të dy, sigurisht, i thanë: Çfarë të doni, vetëm që të shpëtojnë fëmijët. Me një fjalë, u dërguan paratë sa duheshin dhe, në fund, erdhi fjala: ku i doni? Dhe u liruan të tre djemtë.

Tani ju mund të vini dhe të më thoni mua: po mirë, e paskan bërë shqiptarët, apo Ekrem bej Vlora këtë gjë? Po, ama kanë paguar. Po, është e vërtetë që u pagua, por unë mund t’ju sjell një shembull shumë të njohur.

Hebrenjtë e Romës, kur Roma u pushtua nga gjermanët, u përballën me një kërkesë: Të mbledhej floriri. Gjermanët, nuk dua të gaboj me

peshën. Më duket se mblodhën pesëdhjetë tonë, por nuk jam e sigurt. Nuk jam e sigurt për numrin. Ka edhe një film të famshëm për këtë ngjarje. Erdhi i gjithë komuniteti: Çdo njeri që kishte vathë, unaza, bizhuteri, i peshuan të gjitha dhe arritën peshën që donin gjermanët. E morën floririn dhe, pas dy javësh, të gjithë hebrenjtë e Romës u deportuan në Auschwitz. Dhe ky ishte ndryshimi shqiptar. Në këtë rast, vërtet u pagua një çmim, por u shpëtuan fëmijët. Dhe ky është vetëm një shembull nga qindra të tjerë që mund të përmenden, që mund të silleshin. Unë mendoj se çdo shembull është më prekës se tjetri.

Pyetje: Mal Berisha:

Në fakt, duhet thënë se nuk ka njeri të cilit të mos i mbushen sytë me lot, kur mendon jo vetëm se ishte një fat i madh që njerëz të besimit tuaj u shpëtuan këtu, por edhe se vetë qenia shqiptare

demonstroi një fisnikëri kaq të lartë. Ashtu siç e quani edhe ju, kjo fisnikëri u njoh ndërkombëtarisht me titullin “Të Fisnikët midis Kombeve” (*The Righteous Among the Nations*). Sot ne kemi shtatëdhjetë e tre emra të tillë.

Përgjigje: Felicita Jakoel:

Tani janë shtatëdhjetë e pesë, së bashku me ata që ndihmuan.

Pyetje: Mal Berisha

Tani do të doja t’ju drejtoja një pyetje që lidhet me filmin dokumentar që po realizojmë për një figurë shumë të ndritur me origjinë hebraike, e cila shërbeu në Shqipëri në vitet 1930–1933, Herman Bernstein.



Nuk e di se sa të njohur kanë qenë paraardhësit tuaj me këtë figurë, por unë e kam studiuar me shumë kureshtje dhe pasion.

Ai luajti një rol të jashtëzakonshëm në vendimin e marrë nga Mbreti Zog, përmes urdhërimit të konsullatave shqiptare që të pajisnin me viza hebrenjtë që ndiheshin të rrezikuar. Ata mund ta përdornin Shqipërinë si një vend të sigurt, një *safe haven*, ose si një trampolinë, prej nga mund të kalonin drejt vendeve të tjera, qoftë edhe për një kohë të kufizuar.

Kjo bëri që numri i hebrenjve në Shqipëri të rritej ndjeshëm dhe që, pas luftës, shumë prej tyre të

gjenin rrugën e tyre. Një pjesë, siç e dini edhe ju, u vendosën këtu. Çfarë mund të na thoni për këtë?

Përgjigje:Felicita Jakoel:

Unë për Herman Bernstein-in, për të thënë të vërtetën, kam dëgjuar për herë të parë përmes librit tuaj. Nga sa kuptohet, ai ishte një figurë jashtëzakonisht e admirueshme dhe që me siguri ka ndikuar ndjeshëm te Mbreti Zog në hapat që ai ndërmoi, sa kohë ishte në pushtet, për të lehtësuar hyrjen e hebrenjve të përndjekur në Shqipëri.

Një nga shembujt më domethënës në këtë drejtim, sipas mendimit tim, janë mjekët që erdhën në Shqipëri në atë periudhë. Për shembull, doktori Lehmann, i cili u bë themelues i pavionit të sëmundjeve të brendshme në Spitalin e Tiranës. Edhe sot ky pavion mban emrin e tij. Pra, shumë mjekë dhe intelektualë hebrenj erdhën në Shqipëri në atë kohë.

Po ashtu, marrëveshjet që Mbreti Zog po realizonte për të lehtësuar ose për t'u dhënë mundësinë mijëra hebrenjve të vinin në Shqipëri, për ta pasur këtë vend si pikë kalimi, qoftë edhe për të jetuar këtu përkohësisht, përbënin një lloj etape kalimtare në jetën e tyre të mëvonshme, drejt Palestinës ose Izraelit.

Fatkeqësisht, Zogu e la Shqipërinë në vitin 1939. Megjithatë, ndikimi i tij si mbret la gjurmë shumë pozitive te intelektualët shqiptarë dhe në politikën shqiptare. Fakti është se edhe qeveria që erdhi tre apo katër vjet më pas, qeveria e Mehdi Frashërit, ndonëse një qeveri kuislinge, mbajti ndaj hebrenjve një qëndrim krejtësisht të ndryshëm nga ai i shumicës së qeverive kuislinge të Europës së asaj kohe.

Pyetje: Mal Berisha:

Ju vetë e keni jetuar rininë tuaj në Shqipëri dhe keni përjetuar, ose keni dëgjuar nga afër,

vendimet e qeverisë diktatoriale komuniste shqiptare për ta kthyer Shqipërinë në një shtet ateist. Kur flasim për shtetin ateist, kemi parasysh ndalimin e çdo forme ushtrimi fetar, as për të krishterët ortodoksë, as për katolikët, as për myslimanët, as për bektashinjtë.

Natyrisht, komuniteti hebraik nuk përbënte përjashtim, as në planin fetar. Edhe ata nuk u ndjenë të sigurt, njësoj si priftërinjtë katolikë të Shkodrës, hoxhallarët apo klerikët ortodoksë. Ju vetë, përtej dallimit fetar, a keni ndjerë një lloj persekutimi gjatë kohës së diktaturës, thjesht sepse ishit hebre?

Përgjigje: Felicita Jakoel:

Jo, jo si hebrenj. Ne nuk kemi ndjerë as antisemitizëm dhe as përndjekje specifike. Kemi jetuar njësoj si gjithë shqiptarët e tjerë. Unë e mbaj mend shumë mirë periudhën kur Shqipëria kaloi nga një vend ku feja ushtrohej lirshëm në një

vend ateist. Këtë periudhë e mbaj mend shumë qartë. Para kësaj, ne festonim festat tona, si Pashkët. Madje, kujtimet e mia më të ëmbla të fëmijërisë lidhen pikërisht me këto mbledhje familjare për të përkujtuar ngjarje që unë nuk do t'i quaja thjesht fetare, sepse për popullin hebre ato janë të lidhura me historinë shumë të lashtë. Janë më shumë se rite fetare.

Pastaj mbaj mend se gjithçka u ndalua dhe çdo gjë filloi të bëhej fshehurazi. Por ne, si hebrenj, nuk jemi përndjekur asnjëherë në mënyrë të veçantë. Gjithmonë ka diçka që unë nuk do ta quaja antisemitizëm. Është më tepër ajo ndjesia e brendshme, kur e kupton se je disi ndryshe. Që në momentin kur përmend emrin, lind menjëherë pyetja: Nga vjen ky emër? Çfarë origjine ka? Sigurisht, kishte edhe raste kur, për arsye fetare, lindnin keqkuptime. Mbaj mend një herë një vajzë që më tha: “Po ju keni vrrarë Krishtin”. Unë isha shumë e vogël atëherë, rreth

dhjetë vjeçe, dhe kjo më bëri shumë përshtypje. Shkova menjëherë te babai, sepse ai ishte për mua burimi kryesor, enciklopedia ime e gjallë. Ai më tregoi gjithë historinë, ashtu siç ishte në të vërtetë, duke e vendosur në këndvështrimin historik.

Dhe mund të them se ai njeri, me gjithçka që më tregonte për historinë e popullit hebre, për vlerat dhe virtytet e tij, më bëri të ndihem krenare që jam hebreje. Një pakicë shumë e vogël, në mes të një popullsie që ishte disi ndryshe nga unë.

Pyetje: Mal Berisha:

Kanë kaluar vite. I gjithë komuniteti hebraik i Shqipërisë u zhvendos drejt atdheut, drejt Tokës së Premtuar dhe të Shenjtë. Ju sot vini dhe shkoni lirshëm në Shqipëri. Keni këtu miq, shokë, njerëz të dashur, por në të njëjtën kohë jeni edhe një emër shumë i njohur, jo vetëm si artiste në Shqipëri, por tashmë edhe si drejtoreshë e

Shoqatës së Miqësisë midis Izraelit dhe Shqipërisë.

Si e ndieni veten? A ndiheni pak të dyzuar? A ndiheni shqiptare dhe hebreje, apo vetëm hebreje? Cila është kjo përzierje e bukur identitetesh?

Përgjigje: Felicita Jakoel:

Kjo është një pyetje që ma bëjnë të gjithë. Dhe, në radhë të parë, unë e ndiej veten shqiptare që jeton në Izrael. Një hebreje që është shqiptare, me origjinë shqiptare dhe hebraike. Pra, kam një identitet të dyfishtë, por kjo më duket se e pasuron njeriun. Nuk kam asnjë problem me këtë dyzim.

Përkundrazi, vij nga një vend që ka shpëtuar kaq shumë jetë hebreje dhe për këtë jam krenare. Jam krenare që jam hebreje, por jam edhe më shumë krenare që jam shqiptare. Ky është një dyzim i lumtur.

Mal Berisha:

Ashtu siç keni edhe emrin.

Felicita Jakoel:

Shumë faleminderit.

